



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian**

**Dokument Parlamentar**

**RAPORT**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”**

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 12 nëntor 2018, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019” *në parim*.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Z. Ditmir Bushati, Minister për Europen dhe Punët e Jashtme si dhe përqësues të Ministrisë së Financave

**1. Qëllimi i projektligjit**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2019.

**Projektbuxheti për vitin 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë** rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe **procesin e integritetit në Bashkimin Europian**.

Projektbuxheti 2019 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. **Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore**, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Në shpenzimet e personelit për vitin 2019, planifikohet kostoja e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë si dhe akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për zbatimin e kësaj reforme. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2019 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integritetit europian.**

**Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2019 vazhdon të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2019, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të strukturave të tjera të administratës publike shqiptare që do të angazhohen në procesin “screening”.**

## **2. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2018-2020**

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2018-2020, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

## **3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit**

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

### **Legjislacioni parësor i BE-së**

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Nenet 313-316 dhe 320-324.

### **Legjislacioni dytësor i BE-së**

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “*Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012*”<sup>1</sup>.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja e BE-së 2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetence ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

## **4. Përfundime**

---

<sup>1</sup> Rregullorja e BE-së Nr 966/2012 është shfuqizuar me efekt nga data 2 Gusht 2018, por disa nene të saj do të zbatohen deri në datën 31 Dhjetor 2018 (nenet 281, pika 1 dhe 282, pika 3, shkronja “c” të Rregullores 2018/1046).

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2019*” nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

**NËNKRYETAR**

**BLEDAR ÇUÇI**